

KONTRATE (AKT THEMELIMI)



Per themelimin e Shoqerise me Pergjegjesi te
Kufizuar me Ortakeri

"ALBAVIA" SHPK

KAPITULLI I

HYRJE

Ne mbeshtetje dhe pajtim me Legjislacionin Shqiptar, perkatesisht te Ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe te privatizimit", Nr. 7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare", Ne Palet Kontraktuese:

1. Shoqeria "Cochery Bourdin Chausse International" SA, Person Juridik i te Drejtes Franceze, me seli ne RUEIL MALMAISON-92565-18, Place de L'Europe, regjistruar ne Regjistrin e Tregtise dhe Shoqerive Tregtare ne NANTERRE, me numrin B 348 866 260, e perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY, me Prokure te Posaqme date 30 Janar 1998, leshuar nga Drejtori Kryesor i Shoqerise, Z. Roger MARTIN dhe konfirmuar nga Z. Alain THABEAULT, noter ne Paris, Gjykata e shkalles se dyte e Republikes Franceze si dhe nga Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Franceze, Dhoma e Tregtise dhe Industrise ne Paris dhe Ambasada Shqiptare ne Paris,

2. Z. Hasan HAFIZI, i biri Ramizit, lindur me 11.02.1955 ne Lezhe, banues ne Tirane-Shqiperi me adrese Rruga "Sami Frasheri", Pall. 20/1, Hyrja 1, Apart. 17, Person Fizik, me numer pasaporte 0121999,

3. Shoqeria "Karl Gega Konstruksion" SHPK, Person Juridik i
te Drejtes Shqiptare, me seli ne SHKODER, Rruga "Marin
Barleti", Pall. 173, rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar dhe
te Shoqerive Tregtare ne TIRANE, me Vendim te Gjykates se
Rrethit Tirane Nr. 3413/2, date 18.03.1998, e perfaqesuar nga
Hasan HAFIZI, me Prokure te Posacme date 20 Mars 1998,
leshuar nga Ortaket e Shoqerise dhe e konfirmuar nga noterja
Shpresa KURTI, Zyra e Noterise Tirane,

me vullnetin tone te lire dhe me zotesi te plote juridike
per te vepruar

VENDOSEM

Sot, me date 20 Mars 1998, ne TIRANE, Republika e Shqiperise,
te themelojme nje Shoqeri te Perbashket, ne formen e
Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortakeri per te
zhvilluar veprimtari te perbashket ekonomike, industriale,
financiare dhe tregtare te emertuar:


"ALBAVIA " SHPK

KAPITULLI II

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA " SHPK do te
kete pozite, status dhe aktivitet te percaktuar ligjor te
bazuar ne dispozitat ligjore per Shoqerite Tregtare, ne
Aktet nenligjore, Aktet e krijimit te Shoqerise dhe ne ato
normativa qe bazohen ne praktiken tregtare.
Shoqeria ka statusin e Personit Juridik te se Drejtes
Shqiptare.

The image shows two handwritten signatures. The signature on the left is more complex and includes the name 'Hasan' written in cursive. The signature on the right is simpler, consisting of several horizontal strokes and a vertical line.

NENI 2

Shoqeria "ALBAVIA " SHPK e ka seline e vet ne TIRANE, Republika e Shqiperise, ne adresen Rruga Sami FRASHERI, Pall. 20/1, Shkalla e pare, Apartamenti 17.

Shoqeria, gjate realizimit te aktivitetit te saj, mund te çele Dege, Filiale apo Zyra Perfaqesimi brenda ose jashte Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ose te vendit te huaj ku ato çelen.

NENI 3

Shoqeria themelohet dhe do te funksionoje per te ushtruar veprimtari me objektiv te pergjithshem ndertimet ne te gjitha fushat.

Shoqeria ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

1. Konsulence, projektme, ndertime dhe supervizione ne fushen e ndertimeve rrugore si me poshte:

- Ndertim rruges te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj).
- Ndertim pistash e aeroportesh.
- Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.
- Punime dherash, sistemime, terracime terrenesh, etj.
- Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijeimit te rrugeve.
- Ndertime te veprave te artit rrugore e hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte, tunele etj).
- Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore.

2. Administrim dhe shfrytezim te guroreve, kavove te zhavorit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknologjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit, industriale etj.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj dhe ne aktivitete te tjera plotesuese qe lidhen direkt apo indirekt me fushen e ndertimeve si me poshte:



- Konsulence, projekttime, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale, hidroteknike, civile, urbanistike, turizmit, ushtarake, objekte kulti, kulturore, sportive etj., perfshire dhe restaurimin, rikonstrukcionin e mirembajtjen e veprave ekzistuese.
- Konçensione dhe investime ne te gjitha fushat.
- Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave, paisjeve dhe makinerive te ndryshme.
- Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknologjive bashkekohore.
- Aktivitet marketingu dhe kualifikim profesional.
- Perfaqesime, ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.
- Shoqeria mund te krijoje per qellime shfrytezimi ambiente çlodhese, pune dhe sherbimi te te gjitha natyrave.
- Shoqeria eshte e organizuar te ushtroje veprimtari ne te gjitha drejtimet, ne kufijte qe e lejon ligji, qe perfshihen ne natyren juridiko-profesionale dhe perputhen me objektin e shoqerise.

Shoqeria mund te lidhe kontrata per sa eshte percaktuar ne paragrafet e meparshme, te hyje ne marredhenie te lira bankare dhe financiare per shfrytezimin e aftesive te saj, kur keto marredhenie Shoqeria i shikon me leverdi per realizimin e qellimit social te objektit te veprimtarise dhe per te siguruar fitime.

NENI 4

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e nevojshem duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit. Ajo gezon te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike qe kryen me persona te trete.

KAPITULLI III


KUSHTET EKONOMIKE DHE BUXHETI

NENI 5

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 000 (Njeqindmije) Leke.

Kapitali i mesiperm ndahet si me poshte:

1. "Cochery Bourdin Chausse International" SA si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 50000 (Pesedhjetmije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 50 % (pesedhjete perqind),



2. Z. Hasan HAFIZI, si Ortak ne Shoqeri kontribon me kapitalin prej 25000 (njetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njetepese perqind),

3. "Karl Gega Konstruksion" SHPK, si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 25000 (njetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njetepese perqind).

Kontributet e Ortakeve regjistrohen ne Librin e llogarive dhe Regjistrin e Shoqerise.

Shumat ne para te Kapitalit Themeltar te Shoqerise jane depozituar ne Banken Tregetare Shqiptare.

Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo natyre nuk eshte i kufizuar.

NENI 6

Shoqeria pergjigjet vetem brenda Kapitalit te saj Themeltar. Ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakeve dhe as keta te fundit nuk mbajne pergjegjesi personalisht per detyrimet e Shoqerise si dhe nuk perballojne humbjet e saj tej kuotes se derdhur prej tyre per themelimin e Shoqerise. Shoqeria gjithashtu nuk pergjigjet per detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas.

NENI 7

Shoqeria fillon veprimtarine e saj nga data e regjistrimit ne Gjykatën e Rrethit Tirane dhe Zyren e Tatim Taksave.

NENI 8

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise dhe investimet e Ortakut te Huaj mbrohen nga shteti, i cili i garanton atij dhe Shoqerise te njejtin trajtim dhe te njejtat te drejta qe Ligji u njej Personave Juridike Shqiptare.

NENI 9

Shoqeria ne kushtet ekonomike te krijuara dhe per zhvillimin e veprimtarise se saj, per çdo vit harton e nderton buxhetin e saj. Te ardhurat qe realizon dhe shpenzimet qe ben Shoqeria gjate veprimtarise financiare vjetore, do te pasqyrohen ne

Bilancin vjetor te Shoqerise sipas Ligjit Nr.7661 dt.19.01.1993 "Per kontabilitetin", duke iu pergjigjur ne menyre korrekte detyrimeve ligjore dhe sistemit fiskal.

NENI 10

Shoqeria e realizon fitimin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, ne perputhje me Kontraten, Statutin dhe Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Fitimi neto i realizuar nga Shoqeria, pasi te jene zbritur shumat qe u takojne detyrimeve fiskale, kostove faktike, fondit rezerve apo zgjerimit te metejshe te aktivitetit, u ndahet Ortakeve perpjestimisht me kuotat e tyre.

Fitimi dhe shperblimet e tjera te Ortakut Francez mund te transferohen lirisht ne valute te konvertueshme ne France, pasi te jene paguar taksat ne Shqiperi konform Legjislacionit.

NENI 11


Llogarite vjetore per efekt te Bilancit do te mbyllen brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes. Vit i ushtruar financiar do te jete viti kalendarik, perjashtimisht viti i pare financiar do te mbyllet me 31 Dhjetor 1998.

NENI 12

Shoqeria ne perputhje me interesat e saj dhe Ligjin e kontabilitetit ka te drejte qe çdo vit te krijojte fonde rezerve dhe fonde te reja financimi e zhvillimi.

Shoqeria do mbaje llogarine rrjedhese te saj ne Banken Tregtare Shqiptare, Banken e Kursimeve dhe Banka te tjera qe percaktohen ne marreveshje te perbashket mes Ortakeve.

Per pasqyrimin e gjendjes se llogarive, Shoqeria do te mbaje gjithë dokumentacionin e nevojshem te percaktuar ne Rregulloren e Brendeshme te saj.



KAPITULLI IV

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

NENI 13

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA" SHPK do te organizohet, drejtohet dhe funksionojë ne baze te Ligjit perkates, Statutit te saj dhe Rregullores se Brendeshme te Shoqerise.

NENI 14

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asamblea e Ortakeve
- Administratoret dhe / ose Administratori i vetem/
- Ekspertet kontabel te autorizuar.

Menyra e perberjes, funksionimit dhe detyrat e te drejtat e tyre percaktohen ne menyre te detajuar ne Statutin e Shoqerise.

NENI 15

Administratore te Shoqerise "ALBAVIA" SHPK do te jene:

1. Z. Hasan HAFIZI
2. Zj. Valentina KRUJA
3. Z. Jean Louis MARCHAND
4. Z. Maurice MOISY

KAPITULLI V


DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 16

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet. Kjo periudhe mund te zgjatet ose shkurtohet me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 17

Ortaket detyrohen reciprokisht te ruajne sekretin e dokumentacionit te Shoqerise qe ka te beje me informacionin,

A large, stylized handwritten signature in black ink, likely belonging to Maurice Moisy, with the initials 'MM' visible. The signature is written in a cursive, flowing style.

teknologjine dhe pervojen e akumuluar prej partnereve apo Shoqerise si dhe te dhenat e ndryshme qe i perkasin asaj. Ata marrin te gjitha masat e duhura per te shmangur publikimin e tyre, qofte edhe pjeserisht. Ortaket jane pergjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve.

NENI 18

Per disiplinimin e jetes organizative dhe veprimtarise ekonomike financiare te Shoqerise, te gjithë personat e punesuar ne te detyrohen te respektojne dhe te zbatojne detyrimet ligjore, Aktin e Themelimit, Statutin, Rregulloren e Brendeshem te Shoqerise, Statusin e personelit, te drejtat e detyrat qe sanksionohen ne keto dokumenta dhe ne Kontraten e punes. Ata jane te detyruar te ruajne sekretin profesional dhe organizativ te Shoqerise.

NENI 19

Kjo Kontrate (Akt Themelimi) si dhe dokumentat perkatese bashkalidhur perfaqesojne vullnetin e plote te paleve. Ajo mund te modifikohet me nje marreveshje te re me shkrim, duke njoftuar nje vendim te tille 6 muaj perpara.

NENI 20


Mosmarreveshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Kontrate midis paleve ose mosmarreveshjet qe mund te lindin dhe qe mund te prekin funksionimin dhe mireadministrimin e Shoqerise, Ortaket zotohen se do t'i zgjidhin me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, atehere ceshtja do te kaloje ne Gjykaten kompetente nga pala e interesuar ne perputhje me rregullat proceduriale te parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

NENI 21

Dispozita te hollesishme per Shoqerine percaktohen ne Statutin e saj qe i bashkalidhet kesaj Kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

NENI 22


Kjo Kontrate (Akt Themelimi) hartohet ne 8 (tete) ekzemplare origjinale per t'iu shperndare Organeve kompetente, Paleve



Kontraktuese dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

NENI 23

Kontrata, pasi u lexua, u gjet e rregullt dhe firmoset pa asnje verejtje nga Ortaket. Kontrata hyn ne fuqi siç eshte percaktuar ne paragrafet e meparshem dhe sipas rregullave ne fuqi.



Kontrata u perpilua ne Tirane, me **20** Mars 1998 dhe permban 23 (njezetetre) Nene ne 9 (nente) faqe. Secili nga Ortaket merr nga nje ekzemplar origjinal.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA TIRANE

Nr. 1375 Rep.
Nr. 249 Kol.

VERTETIM

Ne Tirane, sot me date 19.03.1998 (nentedhjete e tete) u paraqiten para Meje Manushope shorica notere ne kete qytet Z. Hasan Ramiz HAFIZI „Sh.p.k. “KARL GEGA KONSTRUKSION” e ortakeve Hartian Sallaku, Luan Kopliku, Hasan Hafizi dhe Shkelqim Rakipaj perfaqesuar me prokure nga Z. Hasan HAFIZI dhe Sh.A. “ COCHERY BOURDIN CHAUSSE INTERNATIONAAL” perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY te gjithë madhore me zotesi te plote per te vepruar, per identitetin e te cileve u sigurova ne dokumentat perkatese te cilet me vullnetin e tyre te lire e te plote me deklaruan permbajtjen e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Sh.p.k. me ortakeri me emertimin “ALBAVIA” duke nenshkruar para meje dhe une noteri e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI

Manushope shorica
dy



STATUTI



Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar me Ortakeri

"ALBAVIA" SHPK

KAPITULLI I

HYRJE

Ne mbeshtetje dhe pajtim me Legjislacionin Shqiptar, perkatesisht te Ligjeve te Kuvendit Popullor te Republikes se Shqiperise Nr. 7512 date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire dhe te privatizimit", Nr. 7764 date 02.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" dhe Nr. 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrimin tregetar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregetare", Ne Palet Kontraktuese:

1. Shoqeria "Cochery Bourdin Chausse International" SA, Person Juridik i te Drejtes Franceze, me seli ne RUEIL MALMAISON-92565-18, Place de L'Europe, regjistruar ne Regjistrin e Tregtise dhe Shoqerive Tregtare ne NANTERRE, me numrin B 348 866 260, e perfaqesuar nga Z. Maurice MOISY, me Prokure te Posacme date 30 Janar 1998, leshuar nga Drejtori Kryesor i Shoqerise, Z. Roger MARTIN dhe konfirmuar nga Z. Alain THABEAULT, noter ne Paris, Gjykata e shkalles se dyte e Republikes Franceze si dhe nga Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes Franceze, Dhoma e Tregtise dhe Industrise ne Paris dhe Ambasada Shqiptare ne Paris,

2. Z. Hasan HAFIZI, i biri Ramizit, lindur me 11.02.1955 ne Lezhe, banues ne Tirane-Shqiperi me adrese Rruga "Sami Frasheri", Pall. 20/1, Hyrja 1, Apart. 17, Person Fizik, me numer pasaporte 0121999,

3. Shoqeria "Karl Gega Konstruksion" SHPK, Person Juridik i te Drejtes Shqiptare, me seli ne SHKODER, Rruga "Marin Barleti", Pall. 173, rregjistruar ne Rregjistrin Tregtar dhe te Shoqerive Tregtare ne TIRANE, me Vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr. 3413/2, date 18.03.1998, e perfaqesuar nga Hasan HAFIZI, me Prokure te Posacme date 20 Mars 1998, leshuar nga Ortaket e Shoqerise dhe e konfirmuar nga noterja Shpresa KURTI, Zyra e Noterise Tirane,

me vullnetin tone te lire dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar

VENDOSEM

Te themelojme nje Shoqeri Tregtare, njesi me vete, te pavarur, ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar, qe do te administrohet, drejtohet, organizohet dhe do te funksionoje ne regjimin e prones private, mbi bazen e parimeve te ekonomise se tregut dhe kushteve te konkureses se lire, per te siguruar fitime.

Bazuar ne kete vendim dhe ne Aktin e Themelimit, Ortaket

HARTOJNE


Statutin e Shoqerise Tregtare, ne pronesi private, ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar "ALBAVIA" SHPK

KAPITULLI II

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria Tregtare "ALBAVIA" SHPK, qe me poshte do te quhet "Shoqeria", krijohet ne perputhje me dispozitat ligjore per Shoqerite Tregtare, me Aktet nenligjore qe lidhen me praktiken tregtare dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise.



NENI 2

Statuti i Shoqerise, permban dhe rregullon poziten dhe statusin juridik te saj, poziten dhe marredheniet e Ortakeve, pjesemarrjen e Shoqerise si Person Juridik ne qarkullimin juridiko-civil dhe ne marredheniet me te tretet, objektin e Shoqerise, kushtet ekonomike, administrimin dhe organizimin e Shoqerise.

NENI 3

Shoqeria do te realizoje objektin e veprimtarise se saj te vendosur ne Kontraten (Akt-Themelimi) dhe te sanksionuar ne kete Statut, ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj konform Legjislacionit Shqiptar ne fuqi dhe Legjislacionit perkates te vendeve te huaja.

NENI 4

Shoqeria "ALBAVIA " SHPK e ka seline e vet ne TIRANE, Republika e Shqiperise, ne adresen Rruga Sami FRASHERI, Pall. 20/1, Shkalla e pare, Apartamenti 17.

Shoqeria, gjate realizimit te aktivitetit te saj, mund te çele Dege, Filiale apo Zyra Perfagesimi brenda ose jashte Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar ose te vendit te huaj ku ato çelen.

NENI 5

Shoqeria ka statusin e Personit Juridik te se Drejtes Shqiptare. Zotesine juridike per te vepruar dhe kapacitetin profesional, Shoqeria i fiton me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar te Gjykates Tirane dhe Organet Tatimore.

NENI 6

Me cilesine e Personit Juridik me vehte dhe te pavarur, Shoqeria ka vulen, llogarine rrjedhese (ne leke dhe devize) dhe investigimin e saj.

Shoqeria ka te gjitha kondicionet per te ushtruar veprimtari ne baze te Ligjit, te percaktuara me vullnetin e Ortakeve.

NENI 7

Shoqeria do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike pa nderprerje mbi 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Gjykate dhe Organin Tatimor.

NENI 8

Afati i vendosur ne Aktin e Themelimit dhe i sanksionuar ne kete Statut per ekzistencen dhe kohezgjatjen e veprimtarise se Shoqerise, nuk e ndalon Asamblene e Ortakeve, qe te marre vendim, per te pushuar apo zgjatur afatin e veprimtarise se saj.

NENI 9

Objekti i veprimtarise

Shoqeria themelohet dhe do te funksionoje per te ushtruar veprimtari me objektiv te pergjithshem ndertimet ne te gjitha fushat.

Shoqeria ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

1. Konsulence, projektme, ndertime dhe supervizione ne fushen e ndertimeve rrugore si me poshte:
 - Ndertim rrugesht te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (autostrada, superstrada etj).
 - Ndertim pistash e aeroportesh.
 - Ndertim veshjesh asfaltike e shtresash rrugore.
 - Punime dherash, sistemime, terracime terrenesh, etj.
 - Punime te rikonstruksionit, mirembajtjes, sinjalizimit dhe vijeimit te rrugeve.
 - Ndertime te veprave te artit rrugore e hekurudhore te te gjitha kategorive, perfshire dhe ato speciale (ura, viadukte, tunele etj).
 - Punime topogjeodezike, gjeologjike dhe analizash laboratorike per punimet rrugore.
2. Administrim dhe shfrytezim te guroreve, kavove te zhavorit, karierave te rerave bituminoze, impianteve te betonit, impianteve te perzierjeve bituminoze, impianteve te prodhimit te inerteve etj, perfshire dhe tregtimin e materialeve teknologjike te prodhuar si dhe materialeve te ndertimit, industriale etj.

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj dhe ne aktivitete te tjera plotesuese qe lidhen direkt apo indirekt me fushen e ndertimeve si me poshte:

- Konsulence, projektme, ndertime dhe supervizion ne fushat e ndertimeve industriale, hidroteknike, civile, urbanistike, turizmit, ushtarake, objekte kulti, kulturore, sportive etj., perfshire dhe restaurimin, rikonstrukcionin e mirembajtjen e veprave ekzistuese.
- Konçensione dhe investime ne te gjitha fushat.
- Importim dhe eksportim te te gjitha llojeve te materialeve dhe mallrave, paisjeve dhe makinerive te ndryshme.
- Levrim te teknikave te ndertimit sipas teknologjive bashkekohore.
- Aktivitet marketingu dhe kualifikim profesional.
- Perfaqesime, ndermjetesime, kooperime dhe tranzitime per probleme te karakterit te ndryshem per vendas dhe te huaj.
- Shoqeria mund te krijojte per qellime shfrytezimi ambiente çlodhese, pune dhe sherbimi te te gjitha natyrave.
- Shoqeria eshte e organizuar te ushtroje veprimtari ne te gjitha drejtimet, ne kufijte qe e lejon ligji, qe perfshihen ne natyren juridiko-profesionale dhe perputhen me objektin e shoqerise.

Shoqeria mund te lidhe kontrata per sa eshte percaktuar ne paragrafet e meparshme, te hyje ne marredhenie te lira bankare dhe financiare per shfrytezimin e aftesive te saj, kur keto marredhenie Shoqeria i shikon me leverdi per realizimin e qellimit social te objektit te veprimtarise dhe per te siguruar fitime.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e nevojshem duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe rentabilitetit. Ajo gezon te gjitha te drejtat ne veprimtarine juridike qe kryen me persona te trete.



KAPITULLI III

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

NENI 11

Ortakët kanë këto të drejta kryesore, të cilat ushtrohen nepermjet vendimeve të marra nga Asambleja e Ortakeve:

- Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë në përputhje me Aktin Themelues (Kontraten) dhe me këtë Statut, vetë ose nepermjet përfaqësuesve të autorizuar të tyre.
- Të marrin pjesë në rezultatet e veprimtarisë së Shoqërisë në çdo formë dhe sasi qofte, siç parashikohet në Aktin Themelues dhe këtë Statut.
- Të marrin pjesë në Organet e Shoqërisë që janë ose që mund të krijohen nepermjet përfaqësuesve të tyre ose vetë.
- Të kërkojnë dhe t'i japin të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të Shoqërisë, si dhe të gjitha dokumentat e përpunuara të Shoqërisë (Bilancet, Llogaritë ekonomike, Librat e Shoqërisë etj.)
- Të bëjnë propozime dhe t'i paraqesin ato për shqyrtim para Organeve të Shoqërisë.
- Të heqin dorë nga Shoqëria duke ua ofruar kuotat e tyre Ortakut tjetër. Kur ky i fundit heq dorë nga e drejta e parablerjes, Ortaku doreheqës ka të drejtën t'ia transferojë kuotën e vet të treta, në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 12

Ortakët kanë këto detyra kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre në Kapitalin Themelues, në përputhje me Aktin Themelues (Kontraten) dhe këtë Statut.
- Të marrin pjesë në administrimin e Shoqërisë nepermjet Organeve të krijuara prej tyre, vetë ose nepermjet përfaqësuesve që caktojnë ata.
- T'i japin Shoqërisë informacionin e nevojshëm që ka të bëjë me veprimtarinë e saj.
- T'i japin Shoqërisë ndihmën e nevojshme me qellim që të arrihet çdo objektivi që ka lidhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë.

KAPITULLI IV

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 13

Shoqeria eshte krijuar me mjetet financiare te Ortakeve, sipas kontributeve perkatese pagyruar ne Nenin 15 te ketij Statuti, shume e cila perben Kapitalin Themeltar te vene ne dispozicion dhe te depozituar, me themelimin e Shoqerise, ne Degen e Bankes Tregtare Tirane ne emer te Shoqerise.

NENI 14

Kapitali Themeltar i Shoqerise "ALBAVIA" SHPK eshte 100 000 (njqindmije) leke, ndare ne 100 (njqind) pjese (kuota) me vlere 1000 (njemije) leke secila, plotesisht te shlyera. Kjo vertetohet me Mandatin e Arketimit te leshuar nga Dega e Bankes Tregtare Tirane.

NENI 15

Kapitali Themeltar eshte i ndare si me poshte:

1. "Cochery Bourdin Chausse International" SA si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 50000 (Pesedhjetmije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 50 % (pesedhjete perqind),
2. Z. Hasan HAFIZI, si Ortak ne Shoqeri kontribon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind),
3. "Karl Gega Konstruksion" SHPK, si Ortak ne Shoqeri kontribuon me kapitalin prej 25000 (njezetepesemije) leke e barabarte me kuoten e pjesemarrjes ne Shoqeri 25% (njezetepese perqind).

Kontributet e Ortakeve regjistrohen ne Librin e Llogarive dhe Regjistrin e Shoqerise.

Shtimi i kontributeve te Ortakeve ne para apo natyre nuk eshte i kufizuar.

NENI 16

Tere kapitali i Shoqerise zoterohet nga Ortaket. Ata jane te vetmit pronare dhe vetem ata kane te drejte te perdorin kete pasuri, ne emer dhe ne interes te Shoqerise.

NENI 17

Secili nga Ortaket gezon te drejten e doreheqjes nga Shoqeria, duke e motivuar vendimin e tij perpara Asamblese se Ortakeve, sipas Nenit 11 te ketij Statuti. Doreheqja eventuale nuk e liron Ortakun doreheqes nga detyrimet e tij te meparshme ndaj Shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e kesaj te fundit ndaj Ortakut doreheqes.

NENI 18


Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet Ortakeve. Ortaket kane te drejten e parablerjes te kuotave te Ortakut doreheqes. Kut Ortaket heqin dore nga e drejta e parablerjes, Ortaku doreheqes ka te drejten t'ia transferoje kuoten e vet te treteve, ne perputhje me Nenin 20 te ketij Statuti dhe Dispozitat e Legjislacionit Shqiptar.

NENI 19

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferushme me rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve e pasardhesve.

NENI 20

Pjeset e Kapitalit Themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne Shoqeri, vetem me miratimin e shumices se Ortakeve qe perfaqesojne te pakten tre te katertat e pjeseve te Kapitalit Themeltar. Ne rast se Shoqeria nuk ka bere te ditur vendimin e saj brenda tre muajve nga data e njoftimit te fundit sipas paragrafit te mesiperm, miratimi i transferimit konsiderohet i dhene. Ne rast se Shoqeria refuzon te jape miratimen e transferimit, Ortaket, brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te blejne apo te lejojne blerjen e pjeseve te Kapitalit



Themeltar me vleren e percaktuar sipas rregullave te Nenit 11 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 21

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themeltar duhet te vertetohen me nje Akt Noterial. Shoqeria ose te tretet duhet te respektojne keto transferime sapo t'i behen te ditura asaj.

NENI 22

Shoqeria pergjigjet vetem me pasurine e saj (Kapitalin Themeltar); ajo ne asnje rast nuk pergjigjet per detyrimet e Ortakeve dhe as keta te fundit nuk mbajne pergjegjesi personalisht per detyrimet e Shoqerise si dhe nuk perballojne humbjet e saj tej kuotes se derdhur prej tyre per themelimin e Shoqerise.

Shoqeria gjithashtu nuk pergjigjet per detyrimet e Shtetit Shqiptar dhe anasjelltas.

Pjesemarrja ne Shoqeri nuk i pengon Ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

NENI 23

Ne rast se kapitalet e veta te Shoqerise, per shkak te humbjeve te konstatuara ne dokumentet financiare, rezultojne me te vogla se gjysma e Kapitalit Themeltar, Ortaket vendosin, brenda 4 muajve nga miratimi i llogarive qe pasqyrojne kete humbje, mbi mundesine e prishjes se parakohshme te Shoqerise, duke zbatuar klauzolat e Nenit 72 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 24

Ne veprimtarine e saj Shoqeria do te mbeshtetet ne burimet e veta, ne shtesat eventuale qe mund te bejne Ortaket, ne fitimet qe do te realizoje Shoqeria, ne fondet e perkoheshme qe ajo mund te siguroje (Hua dhe Kredi) nga Institucionet Financiare dhe Banka te ndryshme, duke mobilizuar dhe aktivizuar edhe mjete te te treteve ne veprimtarine e saj.

KAPITULLI V

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 25

Veprimtaria e Shoqerise realizohet ne baze te leverdishmerise ekonomike dhe pasqyrohet ne Bilancin e saj. Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise ne emer te vet, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.

NENI 26

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht viti i pare financiar fillon me daten e regjistrimit te Shoqerise ne Gjykate dhe Organet Tatimore dhe perfundon me 31 Dhjetor 1998. Ne rastet kur Shoqeria e mbyll aktivitetin e saj, viti financiar mbaron ne daten e shpalljes se mbylljes se Shoqerise.

NENI 27

Shoqeria e realizon veprimtarine e vet financiare ne perputhje me Planet Ekonomiko-Financiare dhe Programet Ekonomike vjetore. Programet ekonomiko-financiare duhet te parashikojne aktivin dhe pasivin te shprehura ne monedhe te konvertueshme. Ato duhet te paraqesin nje parashikim te fitimeve, te kostos dhe ne çdo rast te rezultateve ekonomike. Kontabiliteti dhe llogaria ekonomike (Bilanci Shoqerise) do te shkruhen dhe do te mbahen ne Shqiperi, duke i dhene Ortakut te Huaj informacionin e nevojshem sipas kerkesave te tij. Rezultatet financiare te veprimtarise se Shoqerise do te percaktohen ne baze te Bilancit vjetor, duke iu pergjigjur ne menyre korrekte detyrimeve ligjore dhe sistemit fiskal. Konvertimi i monedhes shqiptare ne devize te huaj dhe anasjelltas do te behet me kursin e kembimit te Bankes Shqiperise. Llogarite vjetore, per efekt te Bilancit, do te mbyllen brenda tremujorit te pare te vitit pasardhes.

NENI 28

Shoqeria ne perputhje me interesat e saj dhe Ligjin e Kontabilitetit ka te drejte, qe çdo vit, te krijoje fonde rezerve dhe fonde te reja financimi dhe zhvillimi.

Shoqeria do mbaje llogarive rrjedhese te saj ne Banken Tregtare Shqiptare, Banken e Kursimeve dhe ne Banka te tjera qe percaktohen ne marreveshje te perbashketa mes Ortakeve.

Per pasqyrimin e gjendjes se llogarive, Shoqeria do te mbaje gjithë dokumentacionin e nevojshem te percaktuar ne Rregulloren e Brendeshme te saj.

NENI 29

Shoqeria e realizon fitimin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj, ne perputhje me Kontraten, Statutin dhe Legjislacionin Shqiptar ne fuqi.

Fitimi neto i realizuar nga Shoqeria, pasi te jene zbritur shumat qe u takojne detyrimeve fiskale, kostove faktike, fondit rezerve apo zgjerimit te metejshem te aktivitetit, u ndahet Ortakeve perpjestimisht me kuotat e tyre.

Fitimi dhe shperblimet e tjera te Ortakut Francez mund te transferohen lirisht ne valute te konvertueshme ne France, pasi te jene paguar taksat ne Shqiperi konform Legjislacionit.

NENI 30

Bilanci vjetor i Shoqerise, Inventari i pasurise, Raporti i aktivitetit financiar i hartuar nga Administratoret si dhe Raporti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar, miratohen nga Asamblea e Ortakeve, brenda nje afati 6 mujor nga data e mbylljes se vitit financiar.

KAPITULLI VI

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 31

Shoqeria "ALBAVIA" SHPK organizohet, drejtohet dhe funksionon ne baze te dispozitave ligjore per Shoqerite Tregtare, Statutit dhe Rregullores Brendeshme te Shoqerise, si dhe te akteve nenligjore qe lidhen me praktiken tregtare.

NENI 32

Organet Drejtuese

Organet drejtuese te Shoqerise jane:

- Asamblea e Ortakeve
- Administratoret dhe / ose Administratori i vetem/
- Ekspertet kontabel te autorizuar.

NENI 33

Asamblea e Ortakeve

Organi me i larte vendimor i Shoqerise eshte Asamblea e Ortakeve, ne te cilin marrin pjese me te drejte vote, perpjestimisht me kuoten e Kapitalit Themeltar, secili nga Ortaket.

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme. Ajo kryesohet nga nje anetar i zgjedhur nga Ortaket. Kryetari emerone nje sekretar qofte dhe jo Ortak.

NENI 34

Asamblea e Ortakeve drejton veprimtarine e Shoqerise nepermjet mbledhjeve dhe vendimeve qe merren ne te. Vendimet e Asamblese, kur jane konform Ligjit dhe dispozitave te Statutit te Shoqerise, jane te detyrueshme per te gjitha Ortaket dhe Administratoret e Shoqerise.

NENI 35


Asamblea thirret ne menytrat dhe afatet ligjore, te cilat parashtrihen ne kete Statut dhe Rregulloren e Brendeshme te Shoqerise.


NENI 36

Asamblea e zakonshme

Asamblea e zakonshme e Ortakeve gjykon dhe vendos per ceshtje te tilla si me poshte:

- Per miratimin ose jo te Bilancit vjetor.
- Per emerimin ose zevendesimin dhe shperblimin e Administratorit te vetem ose te Administratoreve.
- Per direktivat strategjike per zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise.



- 
- Per krijimin dhe mbylljen e Degeve, Filialeve apo Zyrave te Perfaqesimit ne Republiken e Shqiperise apo vende te tjera.
 - Per mundesine e riinvestimit te fitimeve te saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise apo jashte saj, pasi te jene parashtruar nga Administratoret.
 - Per emerimin ose zevendesimin dhe shperblimin e Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
 - Per miratimin ose jo te Raporteve vjetore te Administratorit, Ekspertit Kontabel si dhe raporteve te tjera ekonomiko-financiare qe parashikon ligji.
 - Per menyren e shperndarjes se fitimit dhe planifikimin e kuotave per zhvillimin ekonomiko-financiar te Shoqerise si dhe per ceshtje te tjera qe nuk bien ndesh me Ligjin perkates.

Asamblea e zakoneshme thirret se paku nje here ne vit me paralajmeim me shkrim duke perfshire ketu vendin e ditën, derguar me leter rekomande me pergjigje ne adresen qe shenohet ne Librat e Ortakeve. Asamblea e Zakoneshme vendos me shumice votash.

Çdo Ortak mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te paisur me Prokure te veçante.

Proçes verbalet e Asamblese se Zakoneshme redaktohen nga sekretari i Asamblese dhe nenshkruhen nga Ortaket pjesemarres.

Asamblea Zakoneshme mund te jete plotesisht e vlefshme edhe pa paralajmerim, me kusht qe te jete i pranishem i gjithe kapitali i Shoqerise nepermjete perfaqesuesve te vet.

NENI 37

Asamblea e Jashtezakoneshme

Asamblea e Jashtezakoneshme e Ortakeve gjykon dhe vendos per ceshtje te tilla si me poshte:

- Ndryshimet ne Statut dhe ne Kontraten (Akt-Themelimi).
- Transformimin e Shoqerise nga SH.P.K ne forma te tjera shoqerish.
- Shtimin ose pakesimin e Kapitalit Themeltar.
- Zgjatjen ose pakesimin e kohezgjatjes se veprimtarise se Shoqerise
- Transferimin e kuotave te Kapitalit Themeltar ndermjet Ortakeve apo te treteve.

Asambleja e Jashtezakonshme i merr vendimet e saj me nje shumice votash prej 3/4 e kuotave te perfaqesuara nga Ortaket.

NENI 38

Ne proces-verbalet e Asamblese se Zakoneshme dhe te Jashtezakoneshme kur nje Ortak e kerkon, duhet te pasqyrohen deklaratat e tij.

Proces-verbalet e mbledhjeve te Asambleve mbahen ne gjuhet shqip dhe frengjisht ne vlere te barabarte.

NENI 39

Administratoret

Organi administrativ i Shoqerise jane Administratoret (ose Administratori i vetem) te cilet emerohen dhe konfirmohen ne detyren e tyre nga Asambleja e Ortakeve per nje periudhe 3 vjeçare me te drejte riperseritje.

Administratoret mund te zgjidhen edhe jashte bashkesise se Ortakeve. Administratoreve u njihen te gjitha kompetencat per administrimin e Shoqerise.

NENI 40

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret jane kompetente te ushtrojne çdo veprimtari ne emer dhe per llogari te Shqiperise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky Statut ia njeh ekskluzivisht Asamblese se Ortakeve.

Administratoret jane personalisht pergjegjes kundrejt Shoqerise dhe te tretteve per mosrespektimin e ligjeve, te Statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Kompetencat eskluzive te Administratoreve jane si vijon:

- Te organizojne veprimtarine e Shoqerise me qellim qe te realizohen programet e saj.
- Te sigurojne administrimin e Shoqerise.
- Te perfaqesojne Shoqerine ne mardhenie me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se Shoqerise, me perjashtim te çeshtjeve qe ligji dhe ky Statut i lene ne kompetence te Asamblese se Ortakeve.
- Te siguroje nje zbatim te drejte dhe te sakte te vendimeve te Asamblese Ortakeve.

- Te perfaqesojne Shoqerine perpara autoriteteve gjyqesore, arbitrale dhe administrative ndaj te treteve.
- Te pergatisin raportin mbi administrimin e Shoqerise si dhe inventaret dhe kontabilitetin vjetor.
- Te paraqesin perpara Asamblese se Ortakeve raportin e realizimit te objektivave te Shoqerise.
- Te administroje e drejtoje pasurine e mjetet financiare te Shoqerise brenda caqeve te caktuara nga Asamblea e Ortakeve.
- Te leshoje Prokura per nenpunesit e Shoqerise dhe pergjithesisht per te tretet.

Administratoret (kur jane disa) do te veprojne ne kuadrin e kompetencave te mesiperme gjithnje bashkarisht me nenshkrimin e perbashket e se paku te dy prej tyre.

NENI 41

Marreveshjet ndermjet Shoqerise dhe nje prej Administratoreve ose Ortakeve te saj rregullohen sipas klauzolave te Nenit 51 te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

NENI 42

Administratore te Shoqerise "ALBAVIA" SHPK do te jene:

1. Z. Hasan HAFIZI
2. Zj. Valentina KRUIJA
3. Z. Jean Louis MARCHAND
4. Z. Maurice MOISY

NENI 43

Eksperti Kontabel i Autorizuar

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te Shoqerise dhe te Filialeve te saj, emerohet nje Ekspert Kontabel i Autorizuar, i cili ngarkohet dhe revokohet nga Asamblea e Zakoneshme e Ortakeve, qe perfaqesojne nje vlere me te madhe se 1/2 e Kapitalit Themeltar per nje periudhe 2 vjeçare me mundesi riperseritjeje.

Eksperti kontabel i Autorizuar nuk duhet te beje pjese ne asnje rast ne Shoqerine e themeluar dhe ne Filialet e saj.



KAPITULLI VII

MARREDHENIET E PUNES

NENI 44

Marredheniet e punes ne Shoqeri, Dege e Filialet e saja, rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e Shoqerise, Legjislacionin Shqiptar dhe kete Statut, nepermjet Kontrates se Punes.

NENI 45

Punesimi i punonjesve ne Shoqeri behet mbi bazen e Kontrates Kolektive te punes.

Ne Kontraten e Punes rregullohen keto ceshtje:

- Kushtet dhe menyra e marredhenieve te punes.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.
- Kohezgjatja e punes, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor dhe festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe trajtimi i punonjesve.
- Pushimi dhe mungesat, detyrimet e punonjesve dhe pergjegjesite e tyre ne zbatimin e detyrave te punes.
- Nderprerja e marredhenieve te punes.
- Pagesat, shperblimet dhe honoraret.

Tipi i Kontrates Kolektive miratohet nga Asamblea e Ortakeve.

NENI 46

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve te saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 47

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise mes saj dhe te punesuarve dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

KAPITULLI VIII

PUSHIMI I VEPRIMTARISE

NENI 48

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te caktuar ne Aktin Themelues (Kontrate), me perjashtim te rasteve kur ky afat shtyhet.

Shoqeria mund te pushoje veprimtarine e saj para afatit me kerkesen e njerit prej Ortakeve dhe me vendim te Asamblese Jashtezakonshme te Ortakeve.

NENI 49

Shoqeria shperndahet:

- Me mbarimin afatit te kohezgjatjes se saj.
- Ne rast se nuk ka mundesi qe te realizohet objekti i Shoqerise.
- Me miratimin e te gjithë Ortakeve.

NENI 50

Likuidimi i Shoqerise behet sipas rregullave te Legjislacionit ne fuqi ne momentin e likuidimit.


Kur shperndahet Shoqeria:

- Asamblea e Jashtezakonshme e Ortakeve emeron Komisionin e Likuidimit, qe paraqet Bilancin e likuidimit, ne baze te te cilit Shoqeria pushon se ekzistuari.
- Pasuria dhe mjetet e vena ne dispozicion te Shoqerise nga Ortaku Huaj mund te kthehen ne vendin e origjines.
- Mjetet financiare dhe ato ne natyre, si dhe çdo pronesi tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se Shoqerise, ndahen ndermjet Ortakeve ne perpjestim me pjeset e tyre ne Kapitalin Themeltar, pasi te jene zbritur dhe bere pagesat per te gjitha detyrimet e shpenzimet e Shoqerise.

NENI 51

Kur pushon veprimtaria e nje Filiali per shkak te saj, afati i mbylljes percaktohet nga Administratoret.

Likuidimi i Filialeve do te behet me te njejten procedure qe parashikohet per pushimin e veprimtarise se Shoqerise.



KAPITULLI IX

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 52

Shoqeria gezon mbrojtjen dhe sigurimin e plote te Ligjit Nr. 7764 date 2.11.1993 "Per Investimet e Huaja", Ligjit Nr. 7638 dt. 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" ne vecanti, si dhe Legjislacionit Shqiptar ne fuqi ne pergjithesi.

NENI 53

Ne rast se ne Republiken e Shqiperise shpallen Ligje, Dekrete e Vendime te cilat synojne nje politike me te favorshme zhvillimi te veprimtarise se Shoqerise nga Legjislacioni ekzistues ne kohen e krijimit te saj, Ortaket kane te drejte t'u drejtohen Organeve Shteterore perkatese qe te aplikohet Legjislacioni me i favorshem.

Ne rast te kundert, d.m.th kur shpallen Ligje, Dekrete e Vendime me karakter jofavorizues per Shoqerine, Shoqeria mbrohet nga garancite qe permenden ne Nenin 46 te ketij Statuti. Nderkaq, Ortaku i Huaj ka te drejten e kerkeses per nderprerjen e funksionimit te veprimtarise se Shoqerise.


NENI 54

Ortaket detyrohen reciprokisht te ruajne sekretin e dokumentacionit te Shoqerise qe ka te beje me informacionin, teknologjine dhe pervojen e akumuluar prej partnereve apo Shoqerise si dhe te dhenat e ndryshme qe i perkasin asaj. Ata marrin te gjitha masat e duhura per te shmangur publikimin e tyre, qofte edhe pjeserisht.

Ortaket jane pergjegjes per demet qe mund te rrjedhin nga mosrespektimi i ketyre detyrimeve.

NENI 55

Per disiplinimin e jetes organizative dhe veprimtarise ekonomike financiare te Shoqerise, te gjithe personat e punesuar ne te, detyrohen te respektojne dhe te zbatojne detyrimet ligjore, Aktin e Themelimit, Statutin, Rregulloren e Brendeshme te Shoqerise, Statusin e personelit, te drejtat e detyrat qe sanksionohen ne keto dokumenta dhe ne Kontraten



e Punes. Ata jane te detyruar te ruajne sekretin profesional dhe organizativ te Shoqerise.

NENI 56

Mosmarrevshjet eventuale qe mund te lindin gjate zbatimit te kesaj Kontrate midis paleve ose mosmarrevshjet qe mund te lindin dhe qe mund te prekin funksionimin dhe mireadministrimin e Shoqerise, Ortaket zotohen se do ti zgjidhin me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, atehere ceshtja do te kaloje ne Gjykatën kompetente nga pala e interesuar, ne perputhje me rregullat proceduriale te parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar.

NENI 57

Ky Statut hartohet ne 8 (tete) ekzemplare origjinale per t'iu shperndare Organeve kompetente, Paleve Kontraktuese dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise.


NENI 58

Statuti, pasi u lexua, u gjet i rregullt dhe firmoset pa asnje verejtje nga Ortaket. Statuti hyn ne fuqi siç eshte percaktuar ne paragrafet e meparshem dhe sipas rregullave ne fuqi.


Statuti u perpilua ne Tirane, me **20** Mars 1998 dhe permban 58 (pesedhjetetete) Nene ne 19 (nentembedhjetete) faqe. Secili nga Ortaket merr nga nje ekzemplar ne secilen gjuhe.

ORTAKET

Hasan Hafizi




Dipt' K. Gaga Konstr. v
përfaqësues i
Hasan Hafizi



Skuptora

Cochery Bourouin Chausse, St. d.
perfaqësues i

Maurice MOISY



permbajtës i Maurice Moisy